



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

**LEGJISLATURA VIII**

***Sesioni pranveror***

**Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim**

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 27.5.2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Ekrem Mustafa, Salih Zyba, Isak Shabani. Ganimete Musliu, Albena Reshitaj dhe Jetmira Vrenezi.

Munguan: Besian Mustafa, Zoran Mojsilović dhe Samra Ilijazi.

I ftuar, ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

*Në këtë mbledhje u propozua ky*

***Rend i ditës:***

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 4.5.2022 dhe 17.5.2022;
3. Votimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2021;
4. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-137 për Pyjet;
5. Raportimi i ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
6. Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, e miratoi rendin e ditës.*

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 4.5.2022 dhe 17.5.2022**

*Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 4.5.2022 dhe 17.5.2022.*

### **3. Votimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2021**

*Kryetarja*, pasi tha se shqyrtimi i raportit dhe diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e kaluar, mirëpo për shkak të kuorumit nuk është votuar, ndërsa në ndërkohë kanë ardhur disa propozime dhe vërejtje dhe propozoi që derisa të shqyrtohen këto vërejtje, të shtyhet votimi i raportit.

*Ganimete Musliu*, tha se para se të votohet ky raport, duhet t'i dëgjojmë vërejtjet që kanë ardhur nga Bordi i AAC-së, sindikatat dhe nga punëtorët. Ndërsa, propozoi që në rregulloren e re të Kuvendit, që është duke u punuar, duhet që të propozohet si amendament, çështja e mosmiratimit të raportit vjetor të agjencive, sepse nëse nuk miratohet raporti, atëherë duhet të merren masa ndaj tyre.

*Kryetarja*, tha se edhe vitin e kaluar i kemi dëgjuar bordin dhe autoritete e tjera për vërejtjet e tyre si dhe e përkrahu propozimin e deputetes Musliu, në lidhje me masat në rast mosmiratimit të raportit,

*Pas votimit, konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, votimi i Raportit të AAC-së për vitin 2021 shtyhet për një mbledhje tjetër.*

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-137 për Pyjet**

*Kryetarja* e paraqiti për shqyrtim Projektligjin 08/L-137 për Pyjet dhe tha se ai është i ndarë në 13 kapituj dhe ka gjithsej 79 nene dhe qëllimi i tij është krijimi i bazës ligjore për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe tokave pyjore si resurse me interes të përgjithshëm. Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave, vlerëson se zbatimi në praktikë i Projektligjit për pyje, do të ketë kosto shtesë buxhetore në shumë prej 4,260,269 euro për MBPZHR-në, përkatësisht për Agjencinë Pyjore, si zbatuese e këtij projektligji, për vitet 2022-2023, mjete këto të cilat nuk janë pjesë e ndarjeve buxhetore të planifikuara me projeksionet buxhetore 2022-2023. Kjo kosto shtesë ndërliidhet me bartjen e kompetencave nga niveli në nivelin qendror, që bazuar në Ligjin për financat e pushtetit lokal, bartja e kompetencave nga niveli lokal në nivelin qendror nuk përcillet edhe me bartje të ndarjeve buxhetore nga niveli komunal në nivelin qendror. Dispozitat e Projektligjit për pyjet janë pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit.

*Pasi që nuk kishte diskutues, ajo ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë*

*Rekomandim:*

*Të miratohet në parim Projektligji 08/L-137 për Pyjet.*

### **5. Raportimi i ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**

*Kryetarja* e falënderoi ministrin z. *Liburn Aliu*, që iu ka përgjigj pozitivisht ftesës së komisionit për raportim dhe tha se paraprakisht ka dërguar një raport pune për të arriturat dhe projektet prioritare të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ajo e ftoi ministrin ta paraqesë raportin dhe iniciativat e ministrisë e pastaj anëtarët e komisionit do të mund të adresojnë pyetjet ose komentet e tyre.

*Liburn Aliu, ministër i MMPHI-së*, në fillim tha se fushëveprimi i ministrisë është i gjerë, por target kryesor janë ndryshimet klimatike dhe po përpiqemi që të gjitha projektet e të gjitha departamenteve të ministrisë, të gjithë qeverisë, madje edhe të komunave, t'iu nënshtrohen politikave të cilat janë në harmoni me mjedisin dhe në përshtatje me situatat e ndryshimeve klimatike.

Në vijim, tha se tre fokuset kryesore me prioritet të ministrisë janë: *çështja e ujërave dhe kapacitetet ujore* janë mjaft të limituara dhe rezervat e ujit, në krahasim me vendet e rajonit,

është shumë e vogël, për shkak se lumenjtë nuk shfrytëzohen dhe menaxhohen mjaftueshëm dhe dalin nga vendi. Kosova ka rezerva të ujit me vetëm 500 milionë metër kub në rezervuare artificiale të ndërtuara nga e kaluara dhe nuk ka pasur ndërtime të rezervuarëve të rinj. Në krahasim me Shqipërinë, kemi 80 herë më pak ujë. Rritja e kapaciteteve ujore dhe racionalizimi i shfrytëzimit të ujit janë prioritet kryesor i ministrisë, i cili do të duhej që brenda 20 vjetëve të ardhshme të ndryshojë, sepse jemi në moment kritik. Edhe ndryshimet klimatike kanë ndikim këtu, sepse të reshurat janë më të pakta se në të kaluarën.

*Ajri dhe helmimi i tokës nga mbeturinat*, mbeturinat e rrezikshme që vijnë nga minierat dhe mbeturinat urbane. Gjendja është e rëndë, sepse trajtimi i mbeturinave bëhet në mënyrë klasike, sepse deponohen në deponi të hapura që kanë ndikim në helmimin e tokës dhe degradimin e mjedisit. Trajtimi i tillë duhet të ndalet dhe duhet të bëhet në harmoni me politikat e BE-së dhe prioritet t'i jepet riciklimit, zvogëlimit, ripërdorimit, prodhimit të energjisë nga to, dhe e fundit, deponimi i tyre. BE synon që deri në vitin 2035 të eliminojë deponitë e hapura, ndërsa te ne projektet që i kemi janë për zgjerim të deponive. Gjendja e rëndë me deponitë është në Mitrovice, Pejë, Gjiilan, Prizren e kudo. Deponia me gjendjen më të rëndë është ajo e Mirashit dhe e Mitrovicës. Minsitria e ka miratuar strategjinë që do të eliminojë këto deponi. Jemi në fazën e draftimit të ToR për studimet e fizibilitetit për mbylljen e këtyre deponive, ndër to është edhe ajo e Mirashit. Mirëpo, para se të mbyllen këto deponi, duhet të mendohet për riciklimin dhe në të gjitha këto qendra duhet të ndërtohen qendrat e riciklimit që krijojnë kushte që të bëhet ndarja e mbeturinave edhe në burim. Në të kaluarën ka pasur pilot-projekte për ndarjen e tyre, mirëpo edhe pse janë ndarë kontejnerët para shtëpive të qytetarëve, por s'ka pasur sukses, sepse ato mbeturina prapë janë bashkuar në një deponi.

*Transporti dhe zvogëlimi i emetimeve të CO2*, të cilat vijnë nga djegia e thëngjillit, karburanteve dhe kjo kërkon një trajtim më kompleks, meqë ndërliiden shumë fusha dhe shumë ministri. Planifikimi qyteteve duhet t'i japë prioritet formave të gjelbra të transportit, duke e zvogëluar praninë e veturave brenda zonave urbane, duke iu dhënë prioritet mënyrave të transportit tjetër, trafiku urban dhe shfrytëzimi i linjave hekurudhore, të cilat kanë ndikime të vogla në ambient. Prishtina është një ndër qytete më ndotura të rajonit, për shkak të veturave, termocentraleve dhe ekonomive familjare që përdorin thëngjill për ngrohje. Përpos planeve të mobilitetit që duhet të organizohen nga komunat e që ministria duhet të jetë aktive, është edhe kontrolli teknik dhe zvogëlimi i emetimeve nga veturat. Nga fusha e ndërtimit të rritet efienca dhe performanca energjetike e ndërtesave, jemi drejt krijimit të legjislacionit dhe rregulloreve që mund të lëshohen "pasaportat e performancës energjetike". Transporti publik që të jetë efikas do të jetë i vështirë pa planet e mobilitetit dhe shiritat e ndarë për autobusë urbanë.

*Transporti hekurudhor*, që të jetë i leverdishëm dhe eficient, rrjeti hekurudhor, bashkë me korridoret, duhet të jenë të kyçura në korridoret evropiane dhe ky është prioritet i cili rritin tonë të infrastrukturës e bën të dobishëm edhe të rëndësishëm. Kemi projekte të rehabilitimit të hekurudhave ekzistuese, aktualisht hekurudha nga Hani i Elezit–Leshak, në tri faza: faza e parë Hani i Elezit-Fushë-Kosovë, faza e dytë Fushë-Kosovë–Mitrovicë dhe faza e tretë Mitrovicë–Leshak. Studim fizibiliteti për të gjitha linjat edhe këtë vit fillojmë me modernizimin e hekurudhës që nënkupton rindërtimin, sinjalizimin dhe elektrifikimin, për Fushë-Kosovë-Pejë dhe Klinë-Prizren. Me BE-në jemi në bisedime për trenin e lehtë Prishtinë-Fushë-Kosovë, që do të ndikonte në ruajtjen e mjedisit, etj. Por kjo është e pamundur pa u zgjidhur linjat e tjera Prishtinë-Pejë, Klinë-Prizren dhe përsëri pa u zgjidhur lidhjet e tjera me korridoret pan-evropiane, si korridori i Adriatikut, e që Republika e Shqipërisë e ka në plan të lidhë portin e Durrësit me portin e Tivarit. E paraqiti një hartë të mundësisë së lidhjes së Prishtinës me korridorin e Adriatikut, që është në linjën mes Durrësit dhe Hanit të Hotit dhe që të shndërrohet në një vend të rëndësishëm për transportin e mallrave. Aktualisht, porti i Durrësit 30% të mallrave i ka për Kosovën dhe të gjitha këto transportohen me rrugë tokësore dhe që të gjitha do të mund të transportohen me një tren. Pastaj, siç është në plan, kur të mund të kyçemi në korridoret e tjera do të rritej rëndësia ekonomike dhe mjedisore edhe më shumë.

Nga fusha e *planifikimit hapësinor* janë bërë projekte të rëndësishme e ndër to është analiza e lokacioneve të mundshme për panele solare, ku janë ndarë tokat bujqësore të rëndësishme dhe zonat e mbrojtura, ndërsa pjesa tjetër është potencialisht e gatshme për prodhimin e energjisë solare që komunat kur të hartojnë PZHK-të e tyre, t'i parashohin si zona për këtë qëllim. Ky projekt do të pasohet me projektin e identifikimit të potencialeve të erës dhe më pas edhe me zonat e mundshme industriale në gjithë vendin. Për databazën e informacionit gjeo-hapësinore, që është shumë i rëndësishëm edhe për institucionet, edhe qytetarët dhe për këtë pritet që ligji të votohet në seancë. Planet e para hapësinore kanë filluar në 2004, ndërsa më parë ka pasur ndërtime dhe zhvillime të shumta, prandaj sot në Prishtinë kemi 75% të ndërtimeve pa leje, këto ndërtime mbesin problem i komunave që duhet t'i zgjidhin dhe ministria është e gatshme të ndihmojë. Pastaj përmendi një projekt me EBRD për unazën e jashtme të Prishtinës dhe memorandumit me Komunën e Prishtinës, që do të ndihmojë në shkarkimin e transportit. Fokus tjetër tha se janë shpronësimet, banimi social dhe banimi i përballueshëm. Për këtë, tha se kemi marrëveshje me IFC-në për banim të përballueshëm dhe synojmë që shteti të krijojë zona të banimit të përballueshëm dhe brenda tyre të këtë edhe banim social e jo siç është tash të jetojnë në geto. Ndërsa, me UN-Habitatin, tha se kemi marrëveshje për përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave.

*Pastaj deputetët shtruan pyetje për ministrin:*

*Kryetarja* pyeti: a është planifikuar dhe a ka filluar ndërtimi i ndonjë rezervuari të ujit? Për deponitë e mbeturinave, a ka ndonjë projekt që ka filluar në të kaluarën e duhet ndërprerë? Për PZHK-të e miratuara më parë e që nuk janë tash në koherencë me ngjarjet në terren, p.sh. përmendi fabrikën e çimentos në Klinë, që sipas PZHK është në rregull, por qytetarët e kundërshtojnë për panelet solare dhe bonitetin e tokave. Ku qëndron problemi për procedurën e tenderimit 16 milionë euro? Dhe në fund për qasjen në dokumente publike nga OJQ-të dhe mediat duhet të përshpejtohet, pasi që kanë probleme në sigurimin e tyre.

*Ganimete Musliu*, pyeti: çfarë projektesh madhore nga fusha e mjedisit ka realizuar ministria gjatë kësaj periudhe, cili është bashkëpunimi me komunat? Më pas, u ndal te disa probleme me mbeturinat ka shumë mbeturina, tek ura e Pestovës, në Plemetin gjithashtu tmerr nga mbeturinat edhe në Brezovicë si vend që vizitohet nga turistët, gjithashtu ka shumë mbeturina dhe ato duhet të inspektohen. Në rrugën e kombit duhet mbjellë disa drunj afër kufirit, duhet të sigurohen shporta për mbeturina, sepse ka pamje të shëmtuar. Për AAC-në, çka keni ndërmarrë që të zgjidhen problemet brenda saj? Për ujin e pijshëm në Komunën e Skënderajt, ku një projekt është hequr nga buxheti dhe ai duhet të kthehet në rishikim të buxhetit ose më së largu në buxhetin e vitit tjetër, pasi 80% e qytetarëve kanë mbetur pa ujë të pijshëm. Për rrugën në Mazgit s'ka asnjë lëvizje në rregullimin e saj; për investimet në fshatrat e veriut Mitrovicës duhet ta këtë vëmendjen kombëtare dhe në fund tha se në Gjilan afër kazermës, lumi është shumë i ndotur dhe potencial për sëmundje dhe duhet të merren masa urgjente nga komuna dhe ministria.

*Albena Reshitaj*, pyeti: a keni ndërmarrë masa të mjaftueshme për ndalimin e ndotjes së ajrit, pasi që nuk është pa veprim i mjaftueshëm? Vendimi për fuzionimin e dy ministrive, MMPH dhe MI, ka qenë i gabuar dhe duhet të ri-analizohen dhe të ndahen. Për ndërtimin e digave ka nisur më herët dhe është siguruar një donacion nga Banka Botërore dhe BE, që e kanë përkrahur një projekt 42.5 milionë dollar për ndërtimin e dy digave në Dragaqinë dhe Kremenatë. A janë këto mjete ende në dispozicion, pasi që ka pasur të fillojë në qershor të vitit 2019, pse është ndërruar lokacioni i ndërtimit të digës së Dragaqinës? Çka është duke bërë ministria për ndërtimin e impianteve të ujërave të zeza? Ka mungesë të informatave për vërshimet dhe ndërhyrjet në shtretër të lumenjve; duhet të fillohet me hulumtime të mirëfillta shkencore për ndryshimet klimatike dhe t'iu jepen mundësia ekspertëve të ndihmojnë në hartimin e strategjive dhe planeve.

*Ministri Liburn Aliu*, iu përgjigj pyetjeve të deputeteve dhe tha: Për digat, nga 500 milionë metër kub ujë, mendoj se deri në vitin 2050, Kosovën duhet ta gjejë me dyfishin e sasisë së ujit në liqene akumuluese. S'ka pasur master-plan që prej vitit 1968, tash janë duke u përgatitur planet e pellgjeve ujore, me ndihmën e shteteve të tjera, si Zvicrës, Suedisë. Për digat e reja janë diga e Firajës, projekt me BE-në dhe është në fazën e fizibilitetit dhe vlerësimit. Projekti tjetër

“**FLAWS**” nga Banka Botërore, do të jetë edhe diga e Dragaqinës, që do të jetë në kuadër të hulumtimeve që do të bëhen. Ky projekt ka qenë së pari për Kamenicë në tri lokacione, Kremenatë, Desivojcë dhe një lokacion tjetër dhe do të përzgjidhet lokacioni në bazë të studimit. Kemi kërkesa për shumë diga, në shumë komuna, por jemi duke bërë studime për arsyeshmërinë e tyre, sepse kemi projekt që s’kanë funksionuar, p.sh. diga në Malishevë, pasi që nuk është studiuar mirë. Prioritetizimi nuk bëhet nga preferencat politike, por nga hulumtimi dhe studimi i përgjithshëm dhe së shpejti do të dalim me një radhitje. Sipas kësaj, dy të parat do të jenë diga e Firajës në Shtërpçë dhe Kremenata në Kamenicë, etj.

Tek ujërat e zeza, janë në kompetencë të ndërmarrjeve rajonale. Ato i raportojnë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Ndërsa, për ujërat e pijes ka humbje deri në 50% të ujit në rrjet dhe duhet investim në modernizimin e rrjetit. Impianti i ujërave të zeza në Prizren dhe Pejë, që janë të rëndësishme. Impianti i Pejës është shumë i avancuar dhe model, pasi përveç ujit, bën trajtimin edhe të mbetjeve dhe përdorimi i tyre për prodhimin e energjisë. Ndërsa, pritet që edhe në Gjilan dhe Mitrovicë të fillojë ndërtimi, por edhe në komuna të tjera, si në Prishtinë, Ferizaj, etj.

Në fushën e planifikimit dhe ndërtimit duhet kemi parasysh se mënyra e planifikimit përpara dhe tash, ndryshojnë për shkak të ndryshimit të ligjit. Pra, koncepti për shkak të ligjit të ri, sepse tani ka PZHK, hartë zonale dhe plane rregulluese në detaje. Prandaj, edhe komunat kanë pasur paqartësi me këtë dhe ka pasur ngecje për hartat zonale, kanë munguar databazat gjeohapësinore digjitale. Planifikimi ka qenë më shumë i fokusuar për zhvillimin e bizneseve sesa në cilësinë e jetës së qytetarit, ka shkuar gjithnjë duke u përmirësuar, por ende jemi larg. Kjo nuk bëhet pa institute të mirëfillta shkencore dhe për ne është me rëndësi dhe me prioritet që institutet që i kemi brenda ministrisë: IPH, IHMK, IKMN të avancohen në institute serioze, sepse kanë qenë të lënë anash.

Është ndalur trendi, sepse nuk duhet ndërtuar në çdo cep, nëse pyeten qytetarët e Bjeshkëve të Nemuna, që është në territorin e komunave Pejë, Gjakovë, Junik, Deçan dhe Istog, ata kanë kërkesa që në çdo pronë private të ndërtohet. Te panelet solare, jemi duke bërë identifikimin në zonat urbane të kulmeve për vendosjen e paneleve solare dhe kjo duhet të rregullohet me ligj nga Ministria e Ekonomisë. Në tokat bujqësore ka forma të paneleve që nuk janë të dëmshme për zhvillimin e bujqësisë. Për qasjen në dokumente publike, në sistemin aktual që e kemi nuk është e lehtë të sigurohen informata dhe kjo do të bëhet më së miri kur të bëhet digjitalizimi i dokumenteve dhe e kemi prioritet, kemi filluar me lejet ujore dhe do të vazhdojmë edhe me lejet e tjera. Në ministri kemi nevojë për auditim të vazhdueshëm të projekteve, duke e parë sesi janë zhvilluar projektet dhe auditimet vijnë pas ankesave të qytetarëve dhe operatorëve edhe në këtë rast të këtij tenderi prej 16 milionë euro, kemi kërkuar auditim.

Raporti i mjedisit do të vijë së shpejti edhe zv. ministri s’ka mundur të vijë sot dhe ai është më i informuar për projektet e infrastrukturës. Mbeturinat, deponitë lokale madje edhe ato qendrore nuk janë përgjegjësi e ministrisë sonë, pasi që janë ndërmarrjet qendrore dhe lokale përgjegjëse për menaxhimin e tyre, edhe pse çështja e mbeturinave është problematikë e ministrisë. Deponia në Koshtovë të Mitrovicës është në gjendje të rëndë dhe mund të ketë ndikime, pra është situatë emergjente pas deponisë së Mirashit. Komuna e Mitrovicës e ka qendrën e riciklimit që nuk është funksionalizuar. Mendojmë se duhet të centralizohet menaxhimi i trajtimit të mbetjeve të fundme, p.sh. të gjitha mbeturinat e rajonit të Mitrovicës duhet të riciklohen përmes qendrës së riciklimit, që duhet të funksionalizohet. Projekt i rëndësishëm është projekti i ngrohjes solare në Komunën e Obiliqit. Më shumë ka kërkesa për projekte për deponi të reja dhe jo për riciklim dhe kjo duhet të ndryshohet. Për autostradën e kombit, mirëmbajtja e saj është një kontratë për mirëmbajtje, pastaj për sinjalistikën. Për AAC-në, është në kompetencë të Kuvendit, sepse janë autoritet i pavarur. Rruga në Mazgit ka filluar dhe në Babimoc projekti do të fillojë. Në fshatrat e Mitrovicës do të kujdesem që projektet të fillojnë sa më shpejt. Për fuzionimin e ministrisë, telashe kemi mjaft, por nuk mund të vlerësojë se është e gabueshme dhe mund të kem performancë të dobët, për shkak të kësaj. Për ajrin ka pasur projekt me JICA dhe është konstatuar se transporti, ngrohja me thëngjill dhe TC janë ndotësit kryesorë të ajrit. Përmirësimi nuk është proces që mund të ndodhë shpejt, pasi që në zonat periferike popullata kryesisht janë të varfër e

që përdorin thëngjillin për ngrohje. Prandaj, duhet ofruar alternativë për ngrohje. Sot ndotësi më i madh është TC “Kosova B”, dhe projekti i vendosjes së filtrave dhe problem ka dalë te bojlerët i cili e vonon për një kohë projektin. Përfshirja dhe bashkëpunimi i universiteteve është i domosdoshëm në gjithë punën edhe projektet e ministrisë dhe të përfshihen në hulumtime konkrete dhe duhet të shohim se një pjesë e licencimeve, trajtimeve laboratorike, t’i bëjmë bashkë me universitetet.

*Isak Shabani*, tha se shumë pyetje u konsumuan dhe pyeti për 8 digat e përmendura, se a ka studim fizibiliteti dhe kur mund të realizohen. Për analizat tek ujërat e ndotura që nuk specifikohen, cilat analiza janë kryer? Përmendi një raport medial i cili thotë se për 4 muaj janë shkakuar 6000 aksidente dhe ka pasur me fatalitet. Kjo sipas ekspertëve si pasojë e rrugëve me gropa dhe rrugëve në ndërtim, çfarë masash ka ndërmarrë ministria? Te liqeni i Batllavës, banorët nuk kanë ujë të pijshëm, pasi është një projekt, kur pritet përfundojë? Rruga Prishtinë – Podujevë, kur pritet të përfundojë?

*Milazim Salijaj*, pyeti: për legalizimin e ndërtimeve pa leje, çka do të bëhet pasi të kalojë afati ligjor i cili është vazhduar dy herë? Po asht, pyeti edhe për regjistrin e pronave ujore. Hedhja e mbeturinave inerte përgjatë rrugëve nacionale dhe lokale dhe nganjëherë i zënë edhe lëshesat, menaxherët e rrugëve a kanë ndërmarrë masa? Ndërtimet e parkingjeve në magjistralen Mitrovicë-Prishtinë-Hani i Elezit, ku bizneset ndërtojnë parkingje në brez rrugor dhe që paraqesin pengesa për komunikacion; shpronësimet me kërkesa të komunave, duhet të kërkohet një regjistër i pronave të uzurpuara, ka komuna që kanë mbi 10 hektarë pronë të uzurpuar. Shpronësimi i pronave në kadastër në autostrada dhe ende pronat janë në emër të pronarëve dhe ata paguajnë tatim në pronë, a është duke u shqyrtuar Udhëzimi administrativ për çmimoren në AKK për ndarjen fizike të pronave, e cila e pengon ndarjen fizike të pronave dhe krijon barrë për qytetarë dhe për njoftimin e qytetarëve me SMS dhe ofrimi qasjes nga gjeodetët e licencuar?

*Salih Zyba*, tha se në raport ka prioritete, por mungojnë afatet për lejet, janë vetëm numerike dhe jo të sqaruara. Pyeti: si është bashkëpunimi me Ministrinë Ekonomisë, ZRRE-së, në lidhje me zonat potenciale për energji? Çka është duke bërë ministria për faktorët e ndotjes së ajrit, siç u përmendën, nga TC, automjetet dhe ekonomitë familjare? Për standardin e shfrytëzimit automjeteve duhet paraparë ndryshimet ligjore, si preventivë për reduktimin e ndotjes përmes kontrollit teknik të standardit të ndotjes.

*Ministri Liburn Aliu*, iu përgjigj pyetjeve: Për digat, tha se e kam shpjeguar më parë me projektin “FLOWS”, ku do të bëhet një hulumtim edhe për sigurinë e digave dhe për digat e reja dhe për shqyrtimin e punëve laboratorike të ujërave, pasi që është punë e përbashkët e disa ministrive. Për aksidente është prioritet siguria në trafik dhe e kemi nënshkruar kontratën për evitimin e gropave dhe për sinjalistikën dhe sistemin elektronik të sigurisë në trafik. Rruga Prishtinë – Podujevë është dashur të bëhen rreth-rrotullime dhe pastaj shpronësime. Kjo do të kryhet së shpejti, sepse janë në proces e sipër, ndërsa nga fshati Luzhan-Besi e që lidhet edhe me autostradën. Për ujin e pijshëm të fshatrave rreth Liqenit të Batllavës është në kompetencën e ndërmarrjes rajonale, ndërsa ne i kemi takuar ndërmarrjet për planet e tyre, ndërsa ne vetëm mund me t’i ndihmojmë.

Legalizimi i ndërtimeve pa leje ka zgjatur me dy ligje dhe po zgjatet edhe me një ligj. Interesimi për legalizim ka qenë i pakët, por do të pasohet me një ligj të ri, i cili do të krijojë kushte më të mira. Për regjistrin e pronave ujore është prioritet në draft-ligjin e ri të ujërave. Për parkingjet dhe mbeturinave inerte, është në kompetencë të ministrisë, por edhe të komunave, por janë pa leje, ndërsa zënia e lëshesave është problem serioz. Për AKK-në, është projekt me BB-në, i cili tenton të lehtësojë procedurat dhe do ta diskutojmë. Prioritet te kadastrin kemi sistemin e adresave në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa rindërtimi i kadastrit është një ndër sfidat më të mëdha.

Raporti që ju kemi dërguar ka qenë vetëm informativ, ndërsa raportimi i mirëfilltë do jetë tjetër. Pajtohem se projektet duhet të kenë edhe afatet, mirëpo ka shumë projekte si të transportit e fushave të tjera. Për potencialet për energji një pjesë e madhe e pyetjeve duhet të jenë për

Ministrinë e Ekonomisë. E di se i kanë në plan. Për automjetet duhet të vendosen standardet dhe duhet ndërtohen mekanizma për zbatim të tyre.

*Në vazhdim, ministri Liburn Aliu, iu përgjigj edhe pyetjeve shtesë të deputetëve.*

*Albena Reshitaj, pyeti: çka do të bëhet me lejet ujore që janë dhënë jashtëligjshëm?*

*Ministri Liburn Aliu, për lejet ujore që janë dhënë jashtëligjshëm, duhet të mendohet sesi të zgjidhen këto situata, pasi që ka raste kur shkeljet janë tek investitori, por edhe tek institucioni. Ka shumë të tilla, sepse janë dhënë leje ujore pa pasur plan. P.sh. për digën e Firajës ka qenë gjithmonë në plan, por aty janë dhënë leje për HC, tash a ka qenë ajo leje e ligjshme apo jo, vendos gjykata, ndërsa ne do të përballemi me pasojat.*

*Ganimete Musliu, edhe njëherë e përsëriti projektin jetik për ujin e pijshëm që ka qenë në implementim, i cili duhet të futet në projektbuxhet. Pastaj pyeti për problemin e shpronësimeve te rruga me 4 korsi Komoran–Klinë e Epërme, se kur do të përfundojë. Në vijim, lexoi një mesazh të një banori të fshatit Lazarevë të Komunës së Obiliqit, i cili thotë se një nënkalim është i bllokuar që 2 vite dhe ka mbi 2 metra ujë dhe është rrezik për qytetarët të kalojnë rrugën në pamundësi që ta shfrytëzojnë nënkalimin.*

*Ministri Liburn Aliu, tha se projekti ka pasur disa faza, ka pasur disa probleme dhe zgjidhja e këtyre problemeve ka qenë shkaktar që është hequr nga buxheti dhe e dimë rëndësinë e këtij projekti dhe do të shohim, pasi që të dalë auditimi. Për shpronësimin e rrugëve, tha se ministria ka probleme shpronësore dhe ministria ka 380 milionë borxhe për shpronësime të kësaj natyre. Për rrugën me 4 korsi do ta shohim prioritetin e zgjidhjes së tyre, ku kemi probleme me gjykatat.*

*Salih Zyba, pyeti për investimet në rrugën Prizren –Prevallë, fati i atij investimi që është shmangur nga vijat buxhetore nga qeveritë e kaluara, mënyra e investimit, trajtimi i mbetjeve dhe trajtimi i zonës së mbrojtur të pellgut të lumit duhet pasur parasysh. Për ligjin për pyjet, pyeti për zonat e mbrojtura parqet nacionale, a do të rregullohet më mirë me këtë ligj mbrojtja e tyre?*

*Ministri Liburn Aliu, tha se nuk e di për projektin te Prevala, ndërsa për degradimet nga inertet do ta qesim inspektoratin në terren. Ligji për pyjet ndikon edhe te pyjet në parqe nacionale. Ministria s'ka kapacitete të mjaftueshme t'i trajtojë pyjet brenda parqeve. Agjencia e Pyjeve është autoritet jashtë pyjeve të parqeve nacionale dhe ka kapacitete më të mëdha për trajtimin e pyjeve. Ndërsa, në pyetjen se a duhet të përfshihet Agjencia e Pyjeve në hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve brenda parqeve nacionale në kuadër të menaxhimit të përgjithshëm të parqeve nacionale, ministri tha se mendimi im subjektiv është po dhe kjo do të ketë ndikim te pyjet në parqe nacionale.*

Në fund, kryetarja e falënderoi ministrin Liburn Aliu.

## **6. Të ndryshme**

Komisioni vendosi të mbajë punëtori njëditore, më 13 qershor 2022, në restorant “Te Pylli i arinjve” te liqeni i Badovcit, për shqyrtimin e 19 projektligjeve që kanë kaluar leximin e parë.

*Kryetarja njoftoi për konferencën ndërparlamentare për transportin që do të mbahet në “Swiss Diamond” dhe tha se kemi konfirmimin e disa shteteve për pjesëmarrje, ndërsa gjatë ditës së dytë të kësaj konference planifikohet të bëhet një udhëtim me tren nga Prishtina në Pejë dhe pastaj nga Peja me autobus deri në Bogaj.*

Deputeti *Isak Shabani*, tha se gjatë shqyrtimit të Projektligjit për pijet alkoolike ka pasur kërkesë t'i vizitojë shoqatat e verëtarëve dhe vreshtarëve në Rahovec dhe është mirë të bëhet tash. *Kryetarja* tha se ka pasur iniciativë edhe më herët nga Besian Mustafa, të kontaktohen këto shoqata dhe të bëhet një propozim-agjendë e vizitës, e pastaj të vendosim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

E përgatiti: *Stafi mbështetës i Komisionit.*

*Fitore Pacolli-Dalipi,*

-----

*Kryetare e Komisionit*